



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Shëndetësisë
dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Brendshme

Nr Prot. 108. Dt. 07.04.2020

Nr. 1761 prot. Datë 07/04/2020

Nr. 2919 prot. Datë 07.04/2020

URDHËR Nr. 240

I

PËRBASHKËT

PËR

**VETËKARANTINIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË TË CILËT
DUAN TË FUTEN NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NGA TË GJITHA PIKAT KUFITARE TOKËSORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 1, shkronja "c" dhe 3, shkronja "a", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik dhe Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJNË:

1. Shtetasit shqiptarë, të cilët paraqiten në pikat e kalimit kufitar tokësor, në shkelje të parimit bazë të mbrojtjes së shëndetit publik nga COVID-19, që nuk janë rezident në vende të tjera, të vetëkarantinojnë për një periudhë 14-ditore, nën masa të rrepta sigurie, me shpenzimet e tyre, në struktura akomoduese pranë pikave kufitare, të përcaktuara nga Ministria e Brendshme.
2. Shtetasit rezidentë në vende të tjera nuk do të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Strukturat e Policisë së Shtetit pranë zonave kufitare të sigurojnë ruajtjen në strukturën akomoduese ku do të jenë personat e vetëkarantinuar.
4. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në këtë urdhër për vetëkarantinim për 14 ditë të personave që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë është i dënueshëm sipas legjislacionit në fuqi.
5. Ngarkohen strukturat vendore, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme, pranë pikave kufitare, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

OGERTA MANASTIRLIU



MINISTRI

SANDËR LLESHAJ

